

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ATMACA” SH.P.K**

Me vullnetin tim të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt-themelimi në cilësinë e Ortakut të Vetëm themelues, Unë; **Z. SERKAN ATMACA**, i biri i Sahap dhe Mahide, shtetas Turk, lindur në Karayazi / Turqi, më 08/05/2000, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U26608437, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijoj sot më datë 21/09/2024 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ATMACA” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Thmelimi i shoqërise tregtare “ATMACA” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

**Neni 1**

**Forma dhe emri i shoqërisë**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “ATMACA” SH.P.K. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

**Neni 2**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë “ATMACA” SH.P.K do të jetë në adresën: **Lagjia nr. 1, Rr. Roma, Nd: 10, Seksioni B, Kat:8, Apt: 47, Njësia Administrative Kamëz, Bashkia Kamëz, Kamëz, Tiranë**. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

**Neni 3**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- Hapje dhe menaxhim të aktiviteteve të ndryshme shërbimi si hotele, Bar – Kafe, Restorante, Bujtina, etj. Si dhe shërbime akomodimi në struktura akomoduese si hotel, motel, hostel, bujtina e të ngjashme.
- Tregti me pakicë e shumicë, import – eksport të çdo lloj malli e produkti, përfshirë edhe mallrat e akcizës si cigare, duhan, alkool të të gjitha llojeve. Shoqëria mund të kryejë me qëllim arritjen e objektivave të biznesit të shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

# “ATMACA” SH.P.K

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

## Neni 4

### Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë “ATMACA” SHPK është i përbërë nga Kontributi në Para, vlera totale e të cilit është **100.00 (njëqind) lekë**. Numri i Pjesëve, Kuotat e Pjesëmarrjes së Ortakut të Vetëm dhe Vlera e Kontributeve, të cilat paraqiten si më poshtë:

#### Ortaku i Vetëm themelues SERKAN ATMACA:

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 100.00 % (njëqind përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 100.00 (njëqind) lekë

Kontributi i Ortakut të Vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta).


## Neni 6

### Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i saj, **Z. SERKAN ATMACA**, i biri i Sahap dhe Mahide, shtetas Turk, lindur në Karayazi / Turqi, më 08/05/2000, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U26608437, dhe banues në adresën **Lagjja nr. 1, Rr. Roma, Nd: 10, Seksioni B, Kat:8, Apt: 47, Njësia Administrative Kamëz, Bashkia Kamëz, Kamëz, Tiranë**.

Administratori është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Specimenti i nënshkrimit:



## Neni 7

### Fitimi

Fitimi do të ndahet në bazë të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 8

### Vendimet e Shoqërisë

Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, i cili është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.



# “ATMACA” SH.P.K

## Neni 9

### Zgjidhja e konflikteve

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, pranë Gjykatave kompetente të Republikës së Shqipërisë.

## Neni 10

### Vula e shoqërisë

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

## Neni 11

### Rregjistrimi i Shoqërisë

Për rregjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personi i autorizuar do të pajiset me Prokurë të Posaçme nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

*Akti i themelimit u përpilua në 3 (tre) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente, ndërsa 1 (një) kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “ATMACA” SH.P.K.*

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
“ATMACA” SH.P.K**

**Z. SERKAN ATMACA**

*Serkan Atmaca*



Përkthet nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

